



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja Nr. 94

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303

Prishtinë, më 12 mars 2014, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Hamza Balje, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Faton Topalli dhe Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

RENDI I DITËS

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.2.2014;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës: 26.2.2014;

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 26.2.2014.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave;

Fikrim Damka – Tha se katër komisionet e përhershme i kanë kthyer raportet për këtë projektligj dhe nuk kanë asnjë vërejtje, të gjitha rekomandojnë miratimin e projektligjit bashkë me amendamentet e propozuara. Në këtë mbledhje tha Damka, ta miratojmë raportin përfundimtar dhe ta përcjellim Projektligjin për miratim të dytë në seancë.

Komisioni, njëzëri miratoi raportin përfundimtar me amendamente për Projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave dhe e procedoi për miratim në seancë.

4. Të ndryshme.

Fikrim Damka – Në këtë pikë, e kemi raportin nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054, për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, që thotë se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054, për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, përmban implikime buxhetore shtesë, që do të duhej të parashiheshin në kornizën e ardhshme buxhetore (në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe ligjet vjetore të buxhetit të Republikës së Kosovës), brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ndërsa amendamentet e propozuara nga Komisionin Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054, për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pasi afati i përcaktuar nga Kryesia e Kuvendit, deri më 10 mars 2014 ka kaluar, ne do t'i rekomandojmë Kryesisë së Kuvendit që ta radhitë raportin për miratim në seancë, pa raportin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

Faton Topalli – Propozoj që gjatë ditëve të ardhshme, në një mbledhje të komisionit të diskutohet për ecurinë e marrëveshjes me Zvicrën për pensionet.

Fikrim Damka – Ne disa herë kemi diskutuar për këtë marrëveshje, por do ta diskutojmë prapë, por një nder kushtet është që të miratohet Ligji për pensionet. Gjithashtu në ditët në vijmë do të intensifikojmë punën tonë në Projektligjin për sigurimin shëndetësor dhe në Projektligjin për Veteranët e UÇK –së.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka